



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

**RAPORTI PËR PROJEKTET E INVESTUARA NË TRASHËGIMI
KULTURORE NGA MKRS 2008-2018**
(Analizë e gjendjes aktuale të trashëgimisë kulturore)

Dhjetor, 2018

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
KAPITULLI I – PROJEKTET KAPITALE NË TRASHËGIMI KULTURORE NË PERIUDHËN (2008 – 2018)	5
Projektet e trashëgimisë arkeologjike	7
Projektet e trashëgimisë arkitektuale	23
Projektet e trashëgimisë shpirtërore (jomateriale)	65
Projekte të tjera të trashëgimisë kulturore	67
KAPITULLI II – PROJEKTET E INVESTUARA NË OBJEKTE PA STATUS TË MBROJTJES LIGJORE.....	69
KAPITULLI III – KOMPANITË NDËRTIMORE QË KANË KRYER PUNIME NË ASETE TË TRASHËGIMISË KULTURORE	71
Shtojca 1. Projektet e planifikuara nga MKRS për vitin 2019	73
GJETJE DHE KONKLUSIONE	75
REKOMANDIME.....	77

HYRJE

KKTK në kuadër të mandatit dhe detyrave që ka në fushën e trashëgimisë kulturore ka hartuar raportin për gjendjen e trashëgimisë kulturore. Ky raport paraqet një pasqyrë dhe analizë të gjendjes së trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës. Raporti përmban analizën e gjendjes sipas kategorive të trashëgimisë kulturore për të cilat MKRS ka ndarë mjete buxhetore për realizimin e projekteve të ndryshme kapitale.

Në bazë të vlerësimit të gjendjes dhe të dhënave të mbledhura, KKTK ndër të tjera ka konstatuar se gjendja e rëndë e trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës vjen si rezultat i planifikimit jo të mirë të prioriteteve financiare, realizimit ad hoc të projekteve, mosvlerësimit të projekteve nga institucioni kompetent (KKTK) siç parashihet në bazë të Ligjit për trashëgimi kulturore. Gjithashtu projektet nuk planifikohen dhe realizohen sipas një plani afatmesëm/afatgjatë dhe sipas një analize për ndërhyrje emergjente konservuese/restauruese. Ndërhyrjet realizohen nga kompanitë ndërtimore të palicencuara si dhe problematika të tjera që paraqiten në kuadër të raportit.

Buxheti i ndarë për çdo vit nuk përmbush pritjet dhe nevojat që ka trashëgimia kulturore e vendit. Megjithëse në periudhën 2008 – 2018 janë ndarë jo pak mjete financiare për projekte të ndryshme kapitale, një gjë e tillë nuk korrespondon me përmirësimin e gjendjes së trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës. MKRS ka hartuar listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme që përmban gjithsej 1595 asete nga të gjitha kategoritë ligjore, me më së shumti nga trashëgimia arkitektuale dhe arkeologjike. Kosova ka 23 asete në mbrojtje të përhershme që nga viti 2016 të shpallura nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

KKTK si në të kaluarën edhe gjatë hartimit të raportit i ka kërkuar bashkëpunim MKRS-së, për arritjen e qëllimit të përbashkët dhe adresimin e sfidave e problemeve me të cilat përballet trashëgimia kulturore. Megjithë mungesën e bashkëpunimit të MKRS në ofrimin e të dhënave lidhur me projektet e realizuara në periudhën 2008-2018, KKTK ka vazhduar punën për përgatitjen e raportit gjithëpërfshirës duke përdorur burime zyrtare të publikuara, ka zhvilluar vizita pune në terren dhe takime me akterë për të parë nga afër gjendjen e aseteve të trashëgimisë kulturore në të cilat ka intervenuar MKRS. Projektligji i buxhetit 2019, ku përfshihet trashëgimia kulturore vazhdon sipas të njejtës praktikë nga vitet e mëhershme duke mos ofruar bazë për përmirësim të gjendjes.


Duhet theksuar se ky raport merr në shqyrtim vetëm projektet kapitale nga MKRS dhe jo projektet që janë zhvilluar nga subvencionet dhe projektet e zhvilluara nga komunat apo projektet e financuara nga fonde ndërkombëtare.

KAPITULLI I – PROJEKTET KAPITALE NË TRASHËGIMI KULTURORE NË PERIUDHËN (2008 – 2018)

MKRS nga viti 2008-2018 ka planifikuar më shumë së 100 projekte kapitale të cilat janë pasqyruar në Ligjet e Buxhetit të Republikës së Kosovës për çdo vit. Vlera e këtyre projekteve në total kap shumën 20,429,242.00 euro (€) milionë të cilat janë të destinuara për ndërhyrje konservuese, restauruese, gërmime arkeologjike, intervenime emergjente, shenjëzim të trashëgimisë kulturore, promovim të trashëgimisë kulturore, kthimi i thesarit arkeologjik dhe etnologjik nga Serbia, trashëgimi shpirtërore, etj. MKRS në trashëgiminë kulturore për periudhën 2008 – 2018 ka planifikuar projekte të ndryshme kapitale për secilin vit duke specifikuar ndarjen e buxhetit sipas destinimit në linja të veçanta buxhetore.

Tabela 1. *Buxheti sipas viteve 2008-2018*


Vitet	Shuma në euro
2008	1,128,801.00
2009	1,636,530.00
2010	1,706,604.00
2011	1,586,604.00
2012	1,445,293.00
2013	1,217,683.00
2014	1,452,683.00
2015	1,172,000.00
2016	1,937,360.00
2017	3,125,684.00
2018	4,020,000.00
Totali	20,429,242.00 €



Grafiku 1. *Buxheti sipas viteve 2008-2018*

Tabela 2. Projektet sipas Kategorive 2008-2018

Arkitekturnale	9,739,868.00
Arkeologjike	5,510,000.00
Projekte të tjera	4,299,374.00
Trashëgimi Shpirtërore	880,000.00
Totali	20,429,242.00 €



Garfiku 2. Projektet sipas kategorive 2008-2018

PROJEKTET E TRASHËGIMISË ARKEOLOGJIKE

Trashëgimia arkeologjike është njëra nga kategoritë ligjore të trashëgimisë kulturore që nënkupton ndërtimet, strukturat dhe grupet e ndërtesave, vendbanime të zhvilluara, objektet e luajtshme, monumentet e llojeve të ndryshme dhe përbërjeve të tyre të gjetura në tokë ose nën ujë. Trashëgimia arkeologjike mund të jetë e mbrojtur përmes një rezervati arkeologjik, ku të mbeturat qoftë të dukshme ose të fshehta (të padukshme) në terren duhet të mbeten të paprekura.

Ministria e Kulturës në periudhën 2008-2018 ka realizuar shumë projekte në gërmime arkeologjike dhe konservim, gjithashtu edhe gërmime me karakter shpëtimi. Gërmimet arkeologjike me karakter shpëtimi nuk janë të specifikuara duke mundësuar shpenzimin e buxhetit edhe për projekte që kanë tjetër destinim.

Kalaja e Prizrenit, Parku Arkeologjik i Ulpianës, Kalaja e Harilaqit, Lokaliteti i Dresnikut, Kalaja e Artanës, Kalaja e Dardanës kanë marrë shumën më të madhe të mjeteve buxhetore të destinuar për projektet e trashëgimisë arkeologjike. Shumë projekte përsëriten për çdo vit, pa prezantuar rezultatet e arritura përmes botimesh e publikimesh shkencore dhe pa bërë ekspozimin e gjetjeve arkeologjike. Artefaktet arkeologjike mbeten të pasistemuara në arka dhe depo të pakonservuara dhe të panjohura për studiuesit dhe publikun. MKRS në bazë të Ligjit për Trashëgimi Kulturore, neni 9.14 dhe neni 9.15 duhet të siguroj hapësirë dhe kushte për ruajtjen, mbrojtjen dhe ekspozimin e objekteve të luajtshme, gjë që deri më sot nuk është bërë në nivel të kënaqshëm.

Ndarja e mjeteve për projekte të paplanifikuara mirë, pa vlerësimin e institucionit kompetent (KKTK), pa përcaktim të qartë prioritetesh si dhe përsëritje projektesh pa një plan menaxhimi dhe strategji konkrete çon në degradim të gjendjes së tyre.

Sikurse për projektet në kategoritë e tjera edhe në kategorinë e trashëgimisë arkeologjike gjatë periudhës 2008-2018, asnjë projekt nuk është dorëzuar për vlerësim në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore ashtu siç parashihet më Ligjin për trashëgimi kulturore nenin 5, pika 5.2 *“Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore vlerëson projektet e propozuara të parashtruara nga institucionet e fushave përkatëse, ndërsa Ministria është përgjegjëse për aprovimin dhe implementimin e këtyre projekteve në baza proporcionale nga buxheti i saj.”*

Tabela 3. *Lista e projekteve kapitale në trashëgimi arkeologjike për periudhën 2010-2018 dhe përmban shumën e përgjithshme për investimet në asete të veçanta*

Nr.	Emri i Projektit	Shuma
1.	Kalaja e Prizrenit	1,130,000.00
2.	Lokaliteti Ulpiana	1,030,000.00
3.	Gërmime Arkeologjike me karakter shpëtimi	560,000.00
4.	Kalaja e Artanës	700,000.00
5.	Lokaliteti Dresnik	430,000.00
6.	Kalaja e Dardanës	400,000.00
7.	Kalaja e Harilaqit	515,000.00
8.	Kalaja e Vushtrisë	220,000.00
9.	Kalaja e Keqekollës	130,000.00
10.	Kalaja e Pogragjës	140,000.00
11.	Fusha e madhe dhe tuma në Sadovinë	45,000.00
12.	Kalaja në Marec	80,000.00
13.	Ura e gurit në Vushtri	50,000.00
14.	Kalaja e Vuçakut	30,000.00
15.	Kalaja e Korishës	50,000.00
Totali		5,510,000.00€

Emri i asetit:	Kalaja e Prizrenit
Statusi ligjor:	Mbrojtje të Përhershme TKRKS2A002
Lokacioni:	Prizren
Shuma e ndarë:	1,130,000.00 €
Viti:	2008-2018
Emri i punëkryesit:	Instituti Arkeologjik i Kosovës

Kalaja e Prizrenit ndodhet në qendrën historike të Prizrenit, konkretisht në rrugën “Kalaja”, është aset i shpallur në mbrojtje të përhershme në kategorinë e trashëgimisë arkeologjike në vitin 2016 nga KKTK me numër unik TKRKS2A002. Në aspektin e qasjes rrugore deri tek aseti vështirë arrihet për shkak të pjerrtësisë, megjithëse ka edhe rrugë alternative për në kala. Ajo është e hapur për vizitorë edhe pse punimet vazhdojnë ende. Vlen të theksohet se është njëri ndër asetet e trashëgimisë kulturore më të vizituara në Kosovë. Gjendja e asetit, viteve të fundit është përmirësuar dukshëm pas punimeve restauruese dhe konservuese që janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen ende si në konsolidimin e mureve rrethuese si dhe elementeve brenda kalasë, por që kanë mbetur ende punë të shumta për t’u bërë.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 26.09.2018

Emri i asetit:	Kalaja e Artanës
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr.2700
Lokacioni:	Artanë
Shuma e ndarë:	700,000.00 €
Viti:	2008-2018
Punëkryesi:	Koto, Beograd; Omega Engineering, Dubrovnik

Kalaja e Artanës gjendet në Novobërdë, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 2700 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkeologjike. Gjendja fizike e asetit është e keqe edhe pse është restauruar/konservuar disa herë, gjatë viteve të fundit. Vërehen çarje, madje ka edhe shembje, pothuajse në të gjitha muret. Qasja në kalanë e Novobërdës nuk është e vështirë pasi rruga shkon deri afër dhe ka tabela informuese dhe orientuese. KKTK nuk ka mundur të sigurojë të dhëna se kush e ka hartuar projektin, kush e ka miratuar këtë projekt dhe kush e ka mbikëqyrë, pasi që muret vetëm sa kanë filluar të dëmtohen, shtresat kulturore brenda kalasë janë dëmtuar dhe materiali i zbuluar nuk është ruajtur nga punëkryesi. Kalaja e Artanës - Novobërdës ka zonë të veçantë të mbrojtur me një sipërfaqe prej 48.16 ha sipas Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 08.10.2018

Emri i asetit:	Municipiumi Ulpiana
Statusi ligjor:	Mbrojtje të Përhershme TKRKS2A001
Lokacioni:	Ulpianë
Shuma e ndarë:	1,030,000.00 €
Viti:	2008-2018
Punëkryesi:	Instituti Arkeologjik i Kosovës në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare dhe universitetin e Prishtinës

Ulpiana shtrihet në komunën e Graçanicës në anën jugore të saj. Në vitin 2016, Ulpiana është shpallur në mbrojtje të përhershme nga KKTK me numër unik TKRKS2A001, në kategorinë e trashëgimisë arkeologjike. Gjendja e asetit është relativisht e mirë, në vitin 2017 është shpallur Park Arkeologjik. Gërmime arkeologjike si dhe konservime në këtë lokalitet bëhen në vazhdimësi, duke përfshirë periudhën nga viti 2008 - 2018. Është e hapur për vizitorë, ka infrastrukturë përcjellëse, tabela orientuese, shtigje për ecje, pushimore, tualete si dhe sigurim. Problematikë në këtë park arkeologjik mbetet çështja e pronësisë, pasi thuajse i gjithë territori është në pronësi private dhe për shfrytëzimin apo zgjerimin e gërmimeve duhet paguar qiraja. Parku Arkeologjik qëndron relativisht më mirë se sa asetet tjera arkeologjike. Megjithë gërmimet dhe punët që janë realizuar në aset, ka mungesë të publikimeve e botimeve për promovim si dhe mungesë të prezantimit dhe ekspozimit të gjetjeve për studim. Edhe pse është shpallur Park Arkeologjik, Ulpiana vazhdon të funksionoj pa një plan të menaxhimit.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 08.10.2018

Emri i asetit:	Kalaja e Harilaqit
Statusi ligjor:	Mbrojtje të Përhershme TKRKS2A004
Lokacioni:	Harilaq
Shuma e ndarë:	515,000.00 €
Viti:	2008-2018
Punëkryesi:	Instituti arkeologjik i Kosovës dhe universiteti i Prishtinës

Kalaja e Harilaqit gjendet në fshatin Harilaq të Komunës së Fushë Kosovës, është aset i shpallur në mbrojtje të përhershme nga KKTK me numër unik TKRKS2A004 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkeologjike. Gërmimet arkeologjike që janë bërë për shumë vite me radhë dhe që vazhdojnë ende kanë nxjerrë në sipërfaqe struktura muresh të cilat i kanë dhënë formë kalasë. Aktualisht, vazhdon konservimi i mureve rrethuese të asetit. Megjithë konservimet e bëra në kalanë e Harilaqit, pjesa më e madhe e saj vazhdon të duket si rrënojë për shkak të punimeve jocilësore të kryera në të. Me theks të veçantë mund të përmendim kishën brënda mureve të kalasë, e cila ka pasur intervenime restauruese/konservuese por pa ndonjë rezultat, madje ka pësuar dëmtime edhe më shumë. Mungojnë shenjat orientuese, shtigjet për ecje për vendodhjen e kalasë së Harilaqit.



Fotografite e bëra nga KKTK më datë 13.09.2018

Emri i asetit:	Kalaja e Dardanës (Kamenicë)
Statusi ligjor:	Mbrojtje e Përkohshme 1198
Lokacioni:	Kamenicë
Shuma e ndarë:	400,000.00 €
Viti:	2008 – 2018
Punëkryesi:	Instituti Arkeologjik i Kosovës

Kalaja e Dardanës (Kamenicës) gjendet mbi kodrinën e këtij qyteti, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 1198 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkeologjike. Gërmimet arkeologjike që janë bërë gjatë viteve të fundit i kanë nxjerrë në sipërfaqe shumicën e mureve të asetit, ku ende vazhdojnë punimet konservuese/restauruese në konsolidimin e tyre. Qasja në aset mund të bëhet vetëm në këmbë, ndërsa gjatë verës edhe me automjete të larta përmes një rruge të paasfaltuar. Shenjat orientuese dhe informuese për vendndodhjen e asetit mungojnë.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 28.09.2018

Emri i asetit:	Lokaliteti arkeologjik i Dresnikut
Statusi ligjor:	Mbrojtje të Përhershme TKRKS2A005
Lokacioni:	Dresnik – Klinë
Shuma e ndarë:	430,000.00 €
Viti:	2014-2018
Punëkryesi:	Instituti Arkeologjik i Kosovës

Lokaliteti arkeologjik i Dresnikut gjendet në fshatin Dresnik të Komunës së Klinës, është aset i shpallur në mbrojtje të përhershme nga KKTK me numrin unik TKRKS2A005 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkeologjike. Lokaliteti arkeologjik i Dresnikut shtrihet në një sipërfaqe rreth 30 ha.

Megjithëse për çdo vit ka pasur gërmime arkeologjike, restaurime dhe konservime aseti vazhdon të ketë një gjëndje jo të mirë. Gjatë gërmimeve arkeologjike të fundit është zbuluar një mozaik unik, kulla e vrojtimit, salla qendrore. Për qasje në këtë aset mungojnë shenjat orientuese, informuese dhe lokaliteti mbetet ende i mbyllur për vizitorë.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 11.09.2018

Emri i asetit:	Kalaja e Pogragjës
Statusi ligjor:	Mbrojtje e Përkohshme 20
Lokacioni:	Pogragjë – Gjilan
Shuma e ndarë:	140,000.00 €
Viti:	2011
Punëkryesi:	Nuk dihet

Kalaja e Pogragjës gjendet në fshatin Pogragjë të qytetit të Gjilanit, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 20 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkeologjike. Gjendja e aseti është shumë e keqe, ekziston vetëm një mur i lartë dhe disa mure rrethuese më të ulëta të cilat kanë filluar të shemben. Aseti është i mbuluar me vegetacion, qasja në të është e vështirë dhe për ta vizituar asetin mund të arrihet vetëm duke ecur në këmbë mbi 30 minuta nga rruga që lidhë Gjilanin me fshatin Pogragjë, ndërsa me veturë është i paarrtshëm. Mungojnë shenjat orientuese që tregojnë vendodhjen e kalasë së Pogragjës.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 28.09.2018

Emri i asetit:	Kalaja e Vushtrrisë
Statusi ligjor:	Mbrojtje e Përhershme nr. TKRKS2A007
Lokacioni:	Vushtri
Shuma e ndarë:	220,000.00 €
Viti:	2010
Punëkryesi:	Nuk dihet

Kalaja e Vushtrrisë gjendet në qendër të Vushtrrisë, është aset i shpallur në mbrojtje të përhershme nga KKTK me numrin unik TKRKS2A007 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkeologjike. Meqë Kalaja gjendet në qendër të qyteti qasja në të është shumë e lehtë. Gjendja aktuale e asetit është kryesisht e mirë pas punimeve restauruese/konservuese në vitet e fundit. Aseti është i hapur për vizitorë të cilët mund të marrin informata rreth kalasë nga ciceroni përkatës.



Fotografitë e bëra nga KKTK më datë 17.09.2018

Emri i asetit:	Kalaja e Keqekollës
Statusi ligjor:	Mbrojtje të Përhershme TKRKS2A006
Lokacioni:	Keqekollë
Shuma e ndarë:	130,000.00 €
Viti:	2017-2018
Punëkryesi:	Instituti Arkeologjik i Kosovës

Kalaja e Keqekollës, gjendet në fshatin Keqekollë të Prishtinës, e cila shtrihet mbi një kodër dhe në një pozicion strategjik nga i cili shihet një territor mjaft i gjerë i rajonit të Prishtinës. Është aset i shpallur në mbrojtje të përhershme nga KKTK në vitin 2016, me numër unik TKRKS2A006 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkeologjike. Mungojnë shenjat, informuese për vendodhjen e kalasë. Qajsa deri në aset është e vështirë, me rrugë të pakalueshme për makinë, ndërsa për të arritur deri në kala duhet ecur në këmbë. Gjendja fizike e asetit nuk është e mirë. Vërehet se ka pasur gërmime arkeologjike dhe ndërhyrje në restaurimin dhe konzervimin e disa pjesëve të mureve por edhe pas këtyre punimeve, kalaja vazhdon të mbetet gërmadhë në një pjesë të madhe.



Fotografite e bëra nga KKTK më datë 10.10.2018

Emri i asetit:	Gjyteti (Kalaja) e Marecit
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr.4303
Lokacioni:	Marec, Prishtinë
Shuma e ndarë:	80,000.00 €
Viti:	2017 – 2018
Punëkryesi:	Instituti Arkeologjik i Kosovës

Gjyteti (Kalaja) e Marecit gjendet në fshatin Marec të komunës së Prishtinës dhe shtrihet në një rën nga kodrinat e shumta të këtij fshati, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 4303 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkeologjike. Identifikimi i asetit bëhet me vështirësi pasi fshati ka një sipërfaqe të madhe malore dhe mungojnë shenjat informuese për vendndodhjen e tij.

Vërehet se gjatë dy viteve të fundit ka pasur pastrim të hapësirës së asetit si dhe gjurmime në disa kuadrate ku janë zbuluar mure të cilët janë lënë të hapura dhe pa përkujdesjen e duhur. Këto mure në këtë gjendje do të shkatërrohen, nuk do të mund t'i rezistojë kushteve atmosferike nëse nuk bëhen konservimet e duhura.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 11.10.2018

Emri i asetit:	Kalaja e Vuçakut
Statusi ligjor:	Mbrojtje e Perkohshme nr.720
Lokacioni:	Vuçak
Shuma e ndarë:	30,000.00 €
Viti:	2017
Punëkryesi:	Instituti Arkeologjik

Kalaja e Vuçakut gjendet në fshatin Vuçak të komunës së Drenasit. Është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 720 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkeologjike. Gërmimet arkeologjike për herë të parë kanë filluar në vitin 2017, duke nxjerrë në pah muret e kalasë dhe objekteve tjera përcjellëse, duke veçuar kishën në të cilën janë bërë nderhyrje konservuese. Gjatë viteve të fundit gjendja e asetit ka filluar të përmirësohet pas gërmimeve dhe punimeve konservuese/restauruese që janë bërë dhe që ende vazhdojnë në konsolidimin e mureve rrethuese të kalasë. Për qasje në këtë aset mungojnë shenjat orientuese dhe tabela informuese.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 17.10.2018

Emri i asetit:	Fusha e Madhe dhe Tuma
Statusi ligjor:	Mbrojtje të Përhershme TKRKS2A008
Lokacioni:	Sadovinë – Viti
Shuma e ndarë:	45,000.00
Viti:	2011-2012
Emri i punëkryesit:	Instituti Arkeologjik

Fusha e Madhe dhe Tuma gjendet në fshatin Sadovinë në komunën e Vitisë. Aseti shtrihet në toka bujqësore të cilat janë prona private dhe shfrytëzohen për mbjelljen e kulturave bujqësore. Është aset i shpallur në mbrojtje të përhershme në vitin 2016 në kategorinë e trashëgimisë arkitekturore nga KKTK, me numrin unik TKRKS2A008. Gjendja aktuale e asetit është jo e mirë dhe nuk vërehet që institucionet janë kujdesur për asetin. Për qasje në këtë aset mungojnë shenjat orientuese dhe tabela informuese.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 28.09.2018

Emri i asetit:	Ura e Vjetër e Gurit
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr. 2851
Lokacioni:	Vushtrri
Shuma e ndarë:	50,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet

Ura e Vjetër e Gurit gjendet në qendër të qytetit të Vushtrrisë, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 2851 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkeologjike. Vërehet se gjatë viteve të mëhershme ura ka pas dëmtime të vazhdueshme. Gjendja fizike e asetit dhe zonës së veçantë të mbrojtur - Ura e Vjetër e Gurit në Vushtrri është e keqe. Nga gërmimet e vitit 2017 janë zbuluar edhe dy harqe të reja, që nuk kanë qenë të identifikuar deri më tani. Traseja e urës është e mbuluar me rërë. Kudo vërehen tuba gurësh të grumbulluar, po ashtu është vërejtur se janë duke u kryer gërmimet pa ndonjë arkeolog, pa ndonjë skicë, plan apo strategji të gërmimeve. Mungojnë shenjat informuese që tregojnë vendodhjen e këtij aset. Ura e Vjetër e Gurit, ka një zonë të veçantë të mbrojtur, me një sipërfaqe 1.63 ha.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 17.09.2018

Emri i asetit:	Kalaja e Korishës
Statusi ligjor:	Mbrojtje të Përhershme TKRKS2A003
Lokacioni:	Korishë, Prizren
Shuma e ndarë:	50,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Instituti Arkeologjik i Kosovës

Kalaja e Korishës gjendet në fshatin Korishë të Prizrenit dhe shtrihet mbi kodrën e këtij fshati. Është aset i shpallur në mbrojtje të përhershme në vitin 2016 nga KKTK me numër unik TKRKS2A003 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkeologjike. Rruga deri tek aseti është e paasfaltuar dhe duhet të qasësh nëpër terren të thepisur. Vërehet se ka pasur gërmime arkeologjike gjatë viteve të fundit, por gjendja e këtij aseti vazhdon të jetë jo e mirë me vetëm disa kuadrate të hapura, për të cilat nëse nuk do të ketë ndërhyrje konservuese/restauruese do të shkatërrohen. Nuk ka shenja orientuese dhe informuese që tregojnë vendodhjen e asetit.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 26.09.2018

PROJEKTET E TRASHËGIMISË ARKITEKTURALE

Trashëgimia arkitekturale është një nga kategoritë ligjore të trashëgimisë kulturore në kuadër të cilës hyjnë monumentet, ansamblët / tërësitë e ndërtesave si dhe fushat e konservimit arkitektural. Ministria e Kulturës në periudhën 2008-2018 ka realizuar shumë projekte kapitale në vlerë prej 9,739,868.00 euro (€). Këto projekte kanë pasur në fokus ndërhyrje konservuese/restauruese, rindërtime, ndërtime objektsh të reja, etj. Në kuadër të kësaj hyjnë edhe intervenimet emergjente për të cilat nuk ka informacione dhe të dhëna se si dhe ku janë realizuar.

Shumë prej projekteve nuk janë realizuar sipas planifikimeve apo kanë mbetur të papërfunduara. Madje ka edhe raste kur projektet janë realizuar në kundërshtim me parimet dhe standardet profesionale.

Gjendja e aseteve të trashëgimisë arkitekturale, përkundër shtimit të fondeve dhe ndërhyrjeve restauruese/konservuese është e keqe dhe vazhdon të rëndohet me kalimin e kohës. Trendi i ndarjes së mjeteve për këto projekte është bërë pa ndonjë planifikim ose analizë të mirëfilltë. Një numër i madh projektsh është zhvilluar në objekte të cilat nuk kanë status të mbrojtjes ligjore si trashëgimi kulturore (*Kapitulli 2*).

Gjithashtu ka raste të rindërtimeve të objekteve të reja në kategorinë e trashëgimisë arkitekturale. Në parim rindërtimi është i ndaluar në trashëgimi kulturore për shkak se bie në kundërshtim me parimin e ruajtjes së autenticitetit, vërtetësisë së gjendjes burimore dhe mundësinë për falsifikim të kujtesës historike. Janë të paktën gjashtë raste të rindërtimeve në asete të trashëgimisë kulturore që nuk kanë marrë parasysh parimin e ruajtjes së tërësishëm të trajtës burimore: Kulla e Habib Xhemjalit, Kulla e Shaban Polluzhës, Kulla e Ilaz Kodrës, Kulla e Rexhë Salihaj, Kulla e Jusuf Gërvalles dhe Shtëpia e Katarina Josipit.

Ndarja e mjeteve për projekte të paplanifikuara mirë, pa ndonjë përcaktim prioritetesh me përsëritje dhe zvarritje projektsh, shpeshherë çon në degradim të gjendjes së tyre. Kështu në Qendrën Historike të Prizrenit përkundër fondeve të mëdha, rrënimet vazhdojnë pandalur dhe nuk ka asnjë përmirësim të gjendjes. Po ashtu, shumë asete tjera si p.sh. Shtëpia e Xhafer Devës megjithë investimet e mëdha për disa vite janë në gjendje të mjerueshme.

Asnjë nga projektet e trashëgimisë arkitekturale të realizuara gjatë periudhës 2008-2018 nuk janë dorëzuar për vlerësim në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, ashtu siç parashihet në Ligjin për Trashëgimi Kulturore - nenin 5 pika 5.2. "*Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore*

vlerëson projektet e propozuara të parashtruara nga institucionet e fushave përkatëse, ndërsa Ministria është përgjegjëse për aprovimin dhe implementimin e këtyre projekteve në baza proporcionale nga buxheti i saj”.

Tabela 4. Lista e projekteve kapitale në trashëgimi arkitekturele për periudhën 2008-2018 përmban shumën e përgjithshme për investimet në asete të veçanta

Nr.	Projekti	Shuma
1.	Renovimi i tërësishëm i Muzeut të Kosovës-Ekspozita e Muzeut	1,133,478.00
2.	Restaurimi dhe Konservimi i Objekteve të TK në Qendrën Historike në Prizren	1,000,000.00
3.	Përfundimi i punimeve në kishat ortodokse	589,600.00
4.	Objekti i MKRS-së në Prizren	400,000.00
5.	Konservimi dhe restaurimi i Shtëpisë së Xhafer Devës	295,000.00
6.	Qendra Historike e Prizrenit	580,000.00
7.	Kulla e Jusuf Gërvallës	200,000.00
8.	Shtëpia e Katarina Josipit	100,000.00
9.	Rehabilitimi i Shtëpisë së Mehmet-Mahmut Agë Gjinolli – Vushtrri	115,600.00
10.	Objekti muze “Nënë Tereza”	111,206.00
11.	Restaurimi dhe konservimi i kullës së Fazli Boqollit, Raushic, Pejë	150,000.00
12.	Kulla e Habib Avdylit	100,000.00
13.	Kulla e Hasan Rexhë Salihaj në fshatin Sushicë	100,000.00
14.	Kompleksi i Tyrbes dhe Teqës në Topanicë-Kamenicë	50,000.00
15.	Kulla e Dem Ali Pozharit - faza e I	60,000.00
16.	Kulla e Mehmet Dervish Qekaj - faza e I	50,000.00
17.	Mulliri i Haxhi Zekës	40,000.00
18.	Objekti i Taphanës	130,000.00
19.	Kulla e Shaban Polluzhës	160,000.00
20.	Konservimi dhe restaurimi i Shtëpisë së Shaban Agës në Vushtrri	120,000.00
21.	Kompleksi Etnologjik "Emin Gjiku"	160,000.00
22.	Kulla në Oroberdë / Istog	50,000.00
23.	Kulla e Sheremetit në Pejë	40,000.00
24.	Shtëpia e familjes Koruglu në Mitrovicë	40,000.00
25.	Shtëpia e Herticëve në Prishtinë	30,000.00
26.	Qarshia e Gjakovës	50,000.00
27.	Muzeu Shtëpia e Pavaresise	95,000.00
28.	Rezidenca Ibrahim Rugova	60,000.00
29.	Fshati Hoqe e Madhe	25,000.00
30.	Fshati Zym	60,000.00
31.	Shtëpia e Mulla Ademit në Keqekollë	27,000.00
32.	Shtëpia tradicionale Ryshyt Këpuska, Gjakovë	40,000.00
33.	Mulliri dhe Velanica e Visheve në Binq, Viti	20,000.00

34.	Xhamia në Vryqes	30,000.00
35.	Shtëpia e Qehajve, Pejë	25,000.00
36.	Konaku i Mehmet Begollëve	25,000.00
37.	Lagja e Hajdinëve në Terziaj, Gjilan	25,000.00
38.	Shtëpia e Nimon Ferizit, Gjakovë	30,000.00
39.	Kulla e Ethem Godenit, Rogovë	20,000.00
40.	Kulla e Zeqë Ramë Sadrisë, Brovinë	20,000.00
41.	Mulliri, Hambari i Familjes Januzaj në Senik, Malishevë	20,000.00
42.	Mulliri i familjes Kryeziu, Pagarushë, Malishevë	20,000.00
43.	Kulla e familjes Tafollaj në Çadarak, Suharekë	20,000.00
44.	Kisha Katolike në Ferizaj	50,000.00
45.	Konaku i Jashar Pashës	220,000.00
46.	Renovimi i Kullës së Bajraktarëve, Raushiq-Pejë	30,000.00
47.	Konservimi dhe restaurimi i kullës së Isa Boletinit	65,000.00
48.	Konservimi dhe restaurimi i Ndërtesës së IMMK në Prishtinë	190,000.00
49.	Restaurimi i Xhamisë në Syrganë, Skenderaj	22,000.00
50.	Shkolla e parë shqipe në Stubëll, Viti	14,500.00
51.	Kulla e Nuhi Berishës – Kamenicë	55,000.00
52.	Rregullimi i shtëpisë së masakrës në Krushë të Madhe – Rahovec	60,000.00
53.	Rregullimi i Kullës së Ilaz Kodrës	100,000.00
54.	Masat emergjente, sanimi i shtëpive të vjetra	100,000.00
55.	Konservimi dhe restaurimi i shtëpive muze në Lagjen Jasharaj në Prekaz	100,000.00
56.	Katedralja e Prizrenit	170,000.00
57.	Konservimi i Urës në Zallq	93,000.00
58.	Konservimi i Kullës Sahit Gjakovës	93,000.00
59.	Kulla e Sadik Novokazit	46,500.00
60.	Xhamia në Trepç	48,000.00
61.	Kulla e Ali Pashë Drenit Gjakovë	25,000.00
62.	Muzeu Arkeologjik Prizren	67,000.00
63.	Xhamia në Rugovë	40,000.00
64.	Teqja në Hasë	71,448.00
65.	Kompleksi i Varresave në Qabrat Gjakovë	49,853.00
66.	Kulla e Sylëregjëve	40,000.00
67.	Kulla e Din Rugovës	90,000.00
68.	Mejtepi i Ruzhdijes	95,000.00
69.	Kisha e Rakinicës	30,000.00
70.	Konservimi i Urës së Bublrit	50,000.00
71.	Hamami i Prishtinës	100,000.00
72.	Rregullimi i Sheshit të Isa Boletinit	100,000.00
Totali		8,632,185.00 €

Emri i asetit:	Muzeu i Kosovës
Statusi ligjor:	Mbrojtje të Përkohshme nr.2959
Lokacioni:	Prishtinë
Shuma e ndarë:	1,133,478.00€
Viti:	2008-2018
Punëkryesi:	Sh.p.k “VB Studio-Famis CO” Sh.a. Prishtinë ; Sh.p.k. “Euro project Skënderaj”

Ndërtesa e Muzeut të Kosovës gjendet në qytetin e Prishtinës, është ndërtuar nga austriakët për ushtrinë turke në fundin e shek. XIX, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 2959 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Ndërtesa e Muzeut të Kosovës është funksionale e hapur për vizitorë, por në gjendje jo të mirë. Sallat ku ekspozohen artefaktet nuk i plotësojnë kriteret dhe standardet për ruajtjen dhe ekspozimin e tyre. Gjithashtu, depoja e cila gjendet në bodrumin e kësaj ndërtese është tejte e dëmtuar dhe e papërshtatshme për ruajtjen e materialit muzeor. Muzeut i mungon ndriçimi adekuat, kontrolli i lagështisë së ajrit, tabelat informuese, vitrinat për ekspozim dhe infrastruktura tjetër përcjellëse. Megjithëse, ndërtesa është renovuar disa herë, struktura e saj autentike e eksterierit është ruajtur në përgjithësi. Përkundër faktit se janë investuar rreth një milion euro në 10 vitet e fundit, gjendja e muzeut nuk reflekton me investimet e bëra.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 03.09.2018

Emri i asetit:	Kulla e Muhamet Dervish Qekaj
Statusi ligjor:	Mbrojtje e Përkohshme, 3167
Lokacioni:	Irzniq – Deqan
Shuma e ndarë:	50,000.00 €
Viti:	2011
Punëkryesi:	Pleqja

Kulla e Muhamet Dervish Qekaj gjendet në fshatin Irzniq të Deqanit. Kulla është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme në vitin 2017 nga MKRS me numër unik 3167, dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Për t’u qasur deri tek aseti nuk ka shenja oreintuese, informuese që tregojnë vendnodhjen e saj. Në aspektin e qasjes, rruga deri tek aseti është e asfaltuar. Vërehet se në aset ka pasur intervenime restauruese/konservuese dhe duket në gjendje të mirë nga jashtë, ndërsa gjendja ekzistuese e enterierit ishte e pamundur të identifikohet, për shkak se dyert ishin të mbyllura dhe kishte hezitime prej familjarëve që kulla të hapet për vizitorë.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 22.09.2018

Emri i asetit:	Kompleksi Mulliri i Haxhi Zekës
Statusi ligjor:	Mbrojtje të Përkohshme nr.8
Lokacioni:	Pejë
Shuma e ndarë:	40,000.00 €
Viti:	2011
Punëkryesi:	“SMAKAJ” – Suharekë

Kompleksi Mulliri i Haxhi Zekës gjendet në qytetin e Pejës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme nga MKRS me numër unik 8, dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Gjendja fizike e asetit është relativisht e mirë, është e shenjëzuar me tabela informuese. Objekti i mullirit për momentin shfrytëzohet nga organizata joqeveritare ERA-GROUP. Kjo organizatë kujdeset për mirëmbajtjen e tij dhe objektet tjera përcjellëse të mullirit siç është Hambari, ku në vitin 2007 i është rregulluar çatia. Në vitin 2015 është bërë komplet restaurimi i Hambarit nga IOM, dhe sot shfrytëzohet si sallë ku mbahen konferenca dhe trajnime të ndryshme. Mulliri është në pronësi të Kuvendit Komunal të Pejës, intervenime restauruese ka pasur në vitin 2004, MKRS ka financuar 70 përqind të shpenzimeve, kurse Kuvendi Komunal i Pejës, 30 përqind. Mbikëqyrja për punimet restauruese/konservuese janë përcjellë nga IMMK. Mulliri ka qenë funksional deri në vitin 1960 me një sipërfaqe prej 47 ari. Aseti është i hapur për vizitorë dhe hyrja është me pagesë. Kompleksi ka menaxher i cili paguhet nga KK Pejë. I gjithë inventari që gjendet brenda objektit të mullirit është i organizatës ERA GRUP.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 20.09.2018

Emri i asetit:	Shtëpia e Xhafer Devës
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr. 445
Lokacioni:	Mitrovicë
Shuma e ndarë:	295,000.00 €
Viti:	2014 – 2018
Punëkryesi:	NT “PLEQJA” (2014), EO- “Albi Company” Shpk (2018)

Shtëpia e Xhafer Devës gjendet në qendër të qytetit të Mitrovicës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 445 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Gjendja e asetit është shumë e keqe si nga jashtë ashtu edhe brenda. Që nga viti 2014 deri në vitin 2018, MKRS ka planifikuar dhe ndarë mjete financiare në shumë të përgjithshme prej 337,000.00 euro për konservimin dhe restaurimin e këtij asemi, mirëpo gjendja nuk ka ndryshuar, përkundrazi është degraduar. Mungojnë shenjat orientuese për të shkuar deri tek asemi. Në fillim të këtij viti kanë filluar intervenimet në të dhe përkundër që në tabelën e projektit është paraparë që punimet të kryhen në një periudhë prej 80 ditësh, nuk pritet që ato të përfundojnë edhe pas periudhës 160 ditëshe, ndërsa asemi vazhdon të jetë në gjendje shumë të rëndë.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 18.09.2018

Emri i asetit:	Kulla e Shaban Polluzhës
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme, nr.unik 1054
Lokacioni:	Polluzhë, Drenas
Shuma e ndarë:	160,000.00 €
Viti:	2012 dhe 2018
Punëkryesi:	Konzorciumi: “Brothers Group” Prishtinë; “Enex Trade” Pejë dhe “Lindi” Pejë

Aseti Kulla e Shaban Polluzhës gjendet në fshatin Polluzhë të Drenasit, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme në vitin 2014 me numër unik 1054 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Në vitin 2012 ka filluar rindërtimi i kullës dhe deri më tani është bërë vetëm ndërtimi i vrazhdë dhe kulmi i cili ka filluar të dëmtohet ende pa u përfunduar aset. Ky aset i trashëgimisë kulturore është një nga rastet e rindërtimeve ku përveç zhvendosjes nga lokacioni, nuk është marrë parasysh ruajtja e tërësisë së trajtës burimore dhe autenticiteti i tij. Sipas familjarëve që nga viti 2012 nuk është bërë asgjë dhe ky objekt i lënë në këtë gjendje paraqet rrezik edhe për vetë njerëzit. Për këtë aset, MKRS në vitin 2018 ka ndarë 60,000 euro dhe në përgjithësi deri më tani janë ndarë mbi 140,000.00 euro mjete financiare, ndërsa objekti ka mbetur i papërfunduar.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 17.09.2018

Emri i asetit:	Kompleksi i Kishës Katolike Zonja Ndhimtare
Statusi ligjor:	Mbrojtje e Përkohshme nr. 403
Lokacioni:	Prizren
Shuma e ndarë:	170,000.00 €
Viti:	2017-2018
Punëkryesi:	Nuk dihet

Kompleksi i Kishës Katolike Zonja Ndhimtare gjendet në qytetin e Prizrenit. Është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 403 dhe i përkët kategorisë së trashëgimisë arkitekturale.

Gjendja aktuale e asetit nga jashtë është kryesisht e mirë, ku momentalisht brenda në të janë duke u kryer intervenime gjithashtu edhe restaurimi i freskave. Fillimisht ishte bërë pastrimi i sipërfaqeve nga pluhuri, konsolidimi i ngjyrave, plotësimi i boshllëqeve, eliminimi i kripërave, sanimi i plasaritjeve si dhe ripikturimi në sipërfaqen e pikturave. Mungojnë shenjat orientuese për të arritur deri tek ky aset. Punimet është dashur të përfundojnë deri me 28 nëntor 2018.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 25.09.2018

Emri i asetit:	Shtëpia e Shaban Agës
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr.3271
Lokacioni:	Vushtrri
Shuma e ndarë:	120,000.00 €
Viti:	2017 dhe 2018
Punëkryesi:	Nuk dihet

Shtëpia e Shaban Agës gjendet në qytetin e Vushtrisë. Është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 3271 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Aseti është në gjendje jo të mirë me konstruktion mbajtës të dëmtuar dhe është duke shkuar drejt rrënitit. Edhe pse janë ndarë mjete buxhetore nga MKRS për restaurimin/konservimin e shtëpisë, deri më tani nuk janë bërë ndërhyrje dhe si pasojë rrezikohet shembja e tërësishme e Shtëpisë së Shaban Agës. Mungojnë shenjat orientuese për asetin.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 17.09.2018

Emri i asetit:	Kompleks banimi (Emin Gjiku) Muzeu Etnologjik
Statusi ligjor:	Mbrojtje të Përhershme TKRKS1A0010
Lokacioni:	Prishtinë
Shuma e ndarë:	160,000.00 €
Viti:	2015-2018
Punëkryesi:	Nuk dihet

Kjo ndërtesë dikur ka qenë pronë e familjës së njohur të Gjinollëve. Prej vitit 1957, ky grup ndërtesash duke përfshirë këtu shtëpinë e mysafirëve, shtëpinë e shërbëtorëve dhe atë të familjes i takojnë Muzeut të Kosovës. Është shpallur aset në mbrojtje të përhershme në kategorinë e trashëgimisë arkitekturale nga KKTK në vitin 2016, me numër unik TKRKS1A0010

Në anën e majtë prej derës kryesore të oborrit, mund të shihet e vetmja ndërtesë që ka mbijetuar shkatërrimin e Çarshisë së vjetër, e cila është bartur dhe vendosur këtu në vitin 1963. Gjatë viteve 1990-të, ky kompleks është përdorur si muze i natyrës. Në vitin 2003, renovimi i kompleksit ka filluar me ndihmën e donatorëve ndërkombëtar për ta shndërruar atë në Muze Etnologjik që është hapur në vitin 2006. Shtëpia kryesore e kompleksit e shek. 19 është në fazën e restaurimit që ka filluar në tetor të vitit 2017, punimet për momentin janë ndërprerë, dhe renovimi i shtëpisë së mysafirëve e shek. 18 është gjithashtu i nevojshëm. Muzeu Etnologjik është në gjendje jo të mirë, edhe pse i hapur për vizitorë dhe është pikë referuese për turistët e huaj që vizitojnë trashëgiminë kulturore në qytetin e Prishtinës. Kompleksi Emin Gjiku është i rrethuar me mure në të gjitha anët dhe brenda perimetrit nuk ka ndërtime të reja, përveç aneksit të stafit.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 03.09.2018

Emri i asetit:	Kulla e Sheremetit
Statusi ligjor:	Mbrojtje e Përkohshme nr. 1003
Lokacioni:	Pejë
Shuma e ndarë:	40,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet

Kulla e Sheremetit gjendet në qytetin e Pejës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme nga viti 2014, me numër unik 1003 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Gjendja strukturale e asetit nuk është e mirë. Për shkak të rrënimt të kulmit ka pasur dëmtime të mëdha në pjesën e mureve. MKRS ka ndarë mjete buxhetore por deri më tani nuk është bërë ndonjë ndërhyrje për restaurimin e kësaj kulle dhe si pasojë rrezikohet rrënimi i saj. Gjithashtu nuk ka ndonjë shenjë informuese në lidhje me asetin.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 20.09.2018

Emri i asetit:	Shtëpia e familjes Koruglu
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr.3
Lokacioni:	Mitrovicë
Shuma e ndarë:	40,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet

Shtëpia e familjes Koruglu gjendet në qendër të qytetit të Mitrovicës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 3 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Gjendja e asetit është shumë e keqe, kulmi ka filluar të rrënohet si dhe muret e jashtme dhe të brendshme. Tavanet e kateve si dhe dekorimet e brendshme së bashku me inventarin janë drejt shkatërrimit, gjithashtu vërehen dyert dhe dritaret që janë të dëmtuara. Mungojnë shenjat orientuese për të arritur deri tek ky aset si dhe tabela informuese.







Fotografite e bëra nga KKTK me datë 18.09.2018

Emri i asetit:	Kulla e Fazli Buqollit
Statusi ligjor:	Mbrojtje e Përkohshme 554
Lokacioni:	Raushiq – Pejë
Shuma e ndarë:	150,000.00 €
Viti:	2017-2018
Punëkryesi:	Sh.p.k Plegja, Deçan

Kulla e Fazli Buqollit gjendet në Raushiq të qytetit të Pejës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 554 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Aseti është në pronësi private me pronar Sherif Buqollin. Kulla sipas projektit aktual të prezantuar ka shumë ndryshime nga pamja e kullës së vjetër, gjë që tregon se nuk është respektuar trajta burimore e saj. Aseti është në ndërtim e sipër dhe në bazë të informatave pritet që ndërtimi i saj të përfundojë brenda këtij vit. Sipas pronarit në vitin 2017 është bërë vetëm pastrimi dhe janë shpenzuar 10,000.00 euro. Mungojnë shenjat orientuese për të arritur deri tek ky aset.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 22.09.2018

Emri i asetit:	Shtëpia e Herticëve
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr. 3587
Lokacioni:	Prishtinë
Shuma e ndarë:	30,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet

Shtëpia e Herticëve gjendet në lagjen Kodra e Trimave në Prishtinë, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 3587 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Deri në vitin 1992, shtëpia ka shërbyer për banim të familjes Aliu-Hertica dhe më pas i është ndërruar destinimi për t'u kthyer në shkollë, ashtu siç kishte shërbyer gjatë kohës së okupimit kur edhe është djegur. Objekti është shkatërruar gjatë luftës së fundit dhe me iniciativën e familjarëve në vitin 2004 është vendosur një kulm mbrojtës për ta ruajtur nga shkatërrimi i tërësishëm. Gjendja e aseti nuk duket të jetë e mirë, sipas familjarëve nuk ka pasur asnjë ndërhyrje restauruese nga institucionet kompetente, edhe pse për vitin 2018 MKRS ka ndarë 30 mijë euro për këtë aset. Mungojnë shenjat orientuese për të arritur deri tek ky aset.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 10.10.2018

Emri i asetit:	Shtëpia e Katarina Josipit
Statusi ligjor:	Mbrojtje e Përkohshme nr. 3426
Lokacioni:	Zym – Prizren
Shuma e ndarë:	100,000.00 €
Viti:	2012
Punëkryesi:	“Sh.p.k. Albi Company” (2014)

Shtëpia e Katarina Josipit gjendet në fshatin Zym të Prizrenit, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 3426 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Shtëpia ka filluar të rindërtohet në vitin 2013 dhe punimet kanë vazhduar deri në vitin 2018, kur edhe është bërë hapja me rastin mbajtjes së aktivitetit “Takimet e Gjeçovit”. Gjendja ekzistuese e asetit është e mirë, por mungojnë shenjat orientuese dhe tabela informuese për asetin që është në mbrojtje të përkohshme.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 25.09.2018

Emri i asetit:	Kulla e Jusuf Gërvallës
Statusi ligjor:	Mbrojtje e përkohshme, nr. 3211
Lokacioni:	Dubovik, Deçan
Shuma e ndarë:	200,000.00 €
Viti:	2012- 2015
Punëkryesi:	Nuk dihet

Kulla e Jusuf Gërvallës gjendet në fshatin Dubovik të komunës së Deçanit, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 3211 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Kulla është rindërtuar në vendin e kullës së vjetër dhe është në gjendje të mirë fizike. Kulla është e hapur për vizitorë, por nuk ka ciceron dhe vazhdon të jetë pa mirëmbajtje. Nuk ka ndonjë shenjë informuese se është aset kulturor në mbrojtje të përkohshme.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 22.09.2018

Emri i asetit:	Kulla e Bajraktarëve-Binak Dinës
Statusi ligjor:	Mbrojtje e Përkohshme, 540
Lokacioni:	Raushiq–Pejë
Shuma e ndarë:	30,000.00 €
Viti:	2013
Punëkryesi:	Plejja

Kulla e Bajraktarëve – Binak Dinës gjendet në fshatin Raushiq të Pejës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme nga MKRS me numër unik 540 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Nuk ka asnjë shenjë informuese dhe qasja brenda kullës është e mundur vetëm duke kontaktuar familjarët. Vërehet se gjendja e kullës është kryesisht e mirë, por nuk mirëmbahet shumë, oborri është i rrethuar me mure guri, ndërsa aseti qëndron i mbyllur për vizitorë. Kulla e Bajraktarëve është në pronësi private, ka sipërfaqe prej 11 ari. Gjatë vitit 2013 ka pasur punime restauruese/konservuese nga MKRS dhe kanë përfunduar në vitin 2015. Kulla është rindërtuar mbi muret e kullës ekzistuese dhe me gurët e saj. Sipas pronarit kullës janë bërë shumë ndryshime, është ruajtur vetëm pamja e jashtme e kullës së vjetër, ndërsa në brendi gjithçka ka ndryshuar. Nga kjo kullë ka ekzistuar lidhja në formë ure e cila kalonte në kullën tjetër përmes katit të dytë.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 22.09.2018

Emri i asetit:	Kompleksi i Kullës së Isë Boletinit
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr.5
Lokacioni:	Boletin – Zveçan
Shuma e ndarë:	65,000.00 €
Viti:	2013 dhe 2017
Punëkryesi:	Nuk dihet

Kompleksi i Kullës së Isë Boletinit gjendet në fshatin Boletin të Zveçanit, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 5, dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Gjendja e asetit është relativisht e mirë. Në këtë kompleks janë të punësuar 4 persona, dy roje, një mirëmbajtës dhe një ciceron. Gjatë vizitës kompleksi ishte i mbyllur dhe sipas banorëve ky kompleks shumicën e kohës qëndron mbyllur për vizitorë.


Brenda kullës gjenden disa eksponate, veshje, fotografi dhe dorëshkrime të kohës të cilat nuk janë të konzervuara dhe nuk mirëmbahen në nivelin e duhur. Mungojnë shenjat orientuese për të arritur deri tek ky aset.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 18.09.2018

Emri i asetit:	Kulla e Rexhë Salihaj
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme 3210
Lokacioni:	Shushicë- Istog
Shuma e ndarë:	100,000.00 €
Viti:	2013
Punëkryesi:	Sh.p.k Pleqja, Deçan

Kulla e Rexhë Salihaj gjendet në fshatin Shushicë të Istogut, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme nga MKRS me numër unik 3210 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Nuk ka ndonjë shenjë ose tabelë informuese në lidhje me asetin. Kulla është në pronësi private, në gjendje të mirë dhe e hapur për vizitorë. Gjatë vitit 2013-2015 ka pasur punime restauruese/konservuese ne aset. Kulla është rindërtuar në vendin e njëjtë ku ka qenë kulla e vjetër, e cila ishte e shkatërruar gjatë luftës së fundit në Kosovë.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 22.09.2018

Emri i asetit:	Kulla e Habib Xhemajlit
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr. 3116
Lokacioni:	Dobroshec, Drenas
Shuma e ndarë:	100,000.00 €
Viti:	2012
Punëkryesi:	Nuk dihet

Kulla e Habib Xhemajlit gjendet në fshatin Dobroshec të Drenasit, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme në vitin 2014 me numër unik 3116 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Aseti është i mbyllur dhe për vendndodhjen e tij mungojnë shenjat orientuese. Gjendja ekzistuese e asetit është e mirë. Gjatë rindërtimit në vitin 2012 janë përdorur disa materiale të kullës së vjetër, por nuk është në harmoni me trajtën burimore pasi që është jashtë lokacionit original si dhe për shkak se është ndryshuar organizimi i brendshëm.

Aseti është në pronësi private dhe sipas pronarit të kullës Ramadan Avdyli në këtë planifikim buxhetor është paraparë të rregullohet edhe oborri. Pronari disa herë ka bërë kërkesë në institucionet kompetente për rregullimin e oborrit, por nuk ka hasur në mirëkuptim. Kulla mbahet e mbyllur dhe pa mirëmbajtje.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 08.10.2018

Emri i asetit:	Shtëpi banimi IMMK
Statusi ligjor:	Mbrojtje të Përherëshme TKRKS1A009
Lokacioni:	Prishtinë
Shuma e ndarë:	190,000.00 €
Viti:	2015-2018
Punëkryesi:	N.N.P “Arhiko”-ING Prishtinë
Shtëpi banimi IMMK, gjendet në qendër të qytetit të Prishtinës, është aset i shpallur në mbrojtje të përherëshme në vitin 2016 nga KKTK numër unik TKRKS1A009 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Gjendja ekzistuese e asetit është mesatarisht e mirë dhe shfrytëzohet nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës. Mungojnë shenjat orientuese për të arritur deri tek ky aset.	



Fotografite e bëra nga KKTK më datë 03.09.2018

Emri i asetit:	Shtëpia e Mahmut dhe Mehmet Agë Gjinollit
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr.3296
Lokacioni:	Vushtrri
Shuma e ndarë:	115,600.00 €
Viti:	2016-2017
Punëkryesi:	Nuk dihet

Shtëpia e Mahmut dhe Mehmet Agë Gjinollit gjendet në qytetin e Vushtrrisë, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 3296 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitektuale. Edhe pse gjendja e asetit nga pamja e jashtme duket të jetë relativisht e mirë nuk është e hapur për vizitorë dhe nuk ka një mirëmbajtje të duhur. Vërehet se oborri dhe infrastruktura përcjellëse e asetit janë të pakompletuara. Mungojnë shenjat orientuese për të arritur deri tek ky aset dhe tabela informuese.



Fotografite e bëra nga KKTK, me datë 17.09.2018

Emri i asetit:	Muzeu i Pavarësisë së Kosovës Ibrahim Rugova
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr.3373
Lokacioni:	Prishtinë
Shuma e ndarë:	95,000.00 €
Viti:	2015 dhe 2018
Punëkryesi:	Nuk dihet

Muzeu i Pavarësisë së Kosovës, “Ibrahim Rugova” gjendet në qytetin e Prishtinës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 3373, dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale.

Gjendja e asetit nga jashtë duket të jetë e mirë. Përkundër tabelës informuese për orarin e hapjes së muzeut në shumë raste ai është i mbyllur për vizitorë. Mungojnë shenjat orientuese për të arritur deri tek ky aset.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 10.10.2018

Emri i asetit:	Xhamia e Syriganës
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr. 3493
Lokacioni:	Syriganë - Skenderaj
Shuma e ndarë:	22,000.00 €
Viti:	2015
Punëkryesi:	Nuk dihet

Xhamia e Syriganës gjendet në fshatin Syriganë të Skenderajt, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 3493, dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitektuale. Gjendja e asetit është shumë e keqe, thuajse e shkatërruar, pasi që kanë mbetur vetëm muret pjesë e të cilëve ka filluar të rrënohen pasi që xhamia nuk ka kulm. Sipas banorëve të fshatit dhe imamit të xhamisë, ky aset ka qenë funksional deri para 6 viteve. Banorët tregojnë se xhamia ka qenë në gjendje të mirë dhe funksionale, por ka filluar të shkatërrohet pasi që kanë filluar intervenimet restauruese në të. Sipas tyre MKRS ka rindërtuar vetëm një pjesë të murit të oborrit dhe asgjë më shumë. Me iniciativën e banorëve është bërë minarja e xhamisë si dhe objekti përcjellës.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 14.09.2018

Emri i asetit:	Kisha dhe Shkolla Filllore në gjuhën shqipe
Statusi ligjor:	Mbrojtje të Përhershme TKRKS1A006
Lokacioni:	Stubëll e Epërm, Viti
Shuma e ndarë:	14,500.00 €
Viti:	2016
Punëkryesi:	Nuk dihet

Objekti i Kishës dhe Shkolla Filllore në gjuhën shqipe, gjendet në fshatin Stubëll e Epërme e Vitisë, është aset i shpallur në mbrojtje të përhershëm në vitin 2016 në kategorinë e trashëgimisë arkitekturale nga KKTK me numër unik TKRKS1A006. Mungojnë shenjat orientuese, tabela informuese për vendodhjen e asetit. Gjendja ekzistuese e asetit është relativisht e mirë, objekti është i rrethuar por mungon mirëmbajtja adekuate. Aseti është në pronësi të kishës katolike.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 28.09.2018

Emri i asetit:	Kulla e Nuhi Berishës
Statusi ligjor:	Mbrojtje e Përkohshme 4253
Lokacioni:	Svircë – Kamenicë
Shuma e ndarë:	55,000.00 €
Viti:	2011-2017
Punëkryesi:	Nuk dihet

Kulla e Nuhi Berishës gjendet në fshatin Svircë të Kamenicës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 4253 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Gjendja e asetit është shumë e keqe, kulmi ka filluar të shkatërrohet, po ashtu edhe muret e jashtme dhe ato brendshme, inventari i mbetur brenda kullës është në gjendje shumë të keqe. Për të arritur deri tek aseti është vështirë të arrihet, pasi që rruga deri tek kulla është e pakalueshme dhe në këtë fshat nuk ka asnjë banorë. Mungojnë shenjat orientuese për të arritur deri tek aty si dhe tabela informuese.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 28.09.2018

Emri i asetit:	Kulla e Ilaz Kodrës
Statusi ligjor:	Mbrojtje të Perkoshme, nr.4015
Lokacioni:	Prekaz i Epërm - Skenderaj
Shuma e ndarë:	100,000.00 €
Viti:	2016-2017
Punëkryesi:	Nuk dihet

Kulla e Ilaz Kodrës gjendet në fshatin Prekaz i Epërm të Skenderajt, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohëshme nga MKRS me numër unik 4015, dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Me të hyrë në fshatin Prekaz, gjatë gjithë rrugës ka shenja, tabela informuese se ku gjendet kulla e dëshmorit të kombit Ilaz Kodra. Në aspektin e qasjes rrugore deri tek aseti është e asfaltuar dhe lehtë e qasëshme. Gjendja ekzistuese e asetit është e mirë, e hapur për vizitorë, por ka mungesë të ciceronit dhe mirëmbajtje të kullës. Duhet potencuar se me rastin e ndërtimit të kësaj kulle nuk është marrë për bazë tipologjia e kullave tradicionale të zonës së Drenicës.

Brenda kullës gjenden shume fotografi të prijësve dhe dëshmorve të Luftës së fundit në Kosovë. Kulla ka filluar të ndërtohet në vitin 2002 me financimin e familjarve dhe shokëve të tij dhe nga Kuvendi Komunal i Skenderajt.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 19.09.2018

Emri i asetit:	Shtëpia e Mulla Ademit
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr. 4045
Lokacioni:	Keqekollë
Shuma e ndarë:	27,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet

Shtëpia e Mulla Ademit gjendet në fshatin Keqekollë të Prishtinës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme, me numër unik 4045 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale.

Aseti është në gjendje shumë të keqe dhe është drejt shkatërrimit pasi vërehen shembje të mëdha në disa pjesë të kulmit, mureve të brendshme si dhe atyre të jashtme. Mungojnë shenjat orjentuese për të arritur deri tek ky aset.

Për këtë aset MKRS për vitin 2018 sipas linjave buxhetore ka ndarë mjete financiare në shumë prej 27 mijë euro, por që deri më tani nuk duket se ka pasur ndonjë ndërhyrje në të.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 12.10.2018

Emri i asetit:	Shtëpia e Qehajve
Statusi ligjor:	Mbrojtje e Përkohshme nr. 997
Lokacioni:	Raushiq – Pejë
Shuma e ndarë:	25,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet

Shtëpia e Qehajve gjendet në qytetin e Pejës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 997 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Gjendja ekzistuese e asetit është tejet e keqe si nga jashtë ashtu dhe brenda, kanë filluar çarjet e murit dhe shembja e kulmit. Mungojnë shenjat orientuese për të arritur deri tek ky aset.

Edhe pse MKRS ka ndarë mjete finaciare për punimet restauruese/konservuese për vitin 2018, deri më tani nuk është bërë ndonjë ndërhyrje për restaurimin e këtij aset.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 20.09.2018

Emri i asetit:	Çarshia e Gjakovës
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr.334
Lokacioni:	Gjakovë
Shuma e ndarë:	50,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet

Çarshia e Gjakovës gjendet në qytetin e Gjakovës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 334 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Shtrirja e asetit në kompleksin historik të Çarshisë së Madhe fillon nga kompleksi i Lidhjes Shqiptare dega e Gjakovës, në pjesën e quajtur Kryepazari dhe shtrihet deri në anën tjetër që përbën bërthamën e Çarshisë së Madhe, ku gjendet kompleksi historik i Xhamisë së Hadumit. Duhet të veçohet se në vitin 2012 ka pësuar një ndryshim në rrugën e cila dikur ishte e shtruar me kalldrëm tradicional dhe është zëvendësuar me kubëza të kohës moderne. Kjo është në kundërshtim me ligjin e trashëgimisë kulturore dhe ruajtjes së autenticitetit të asetit. Kompleksi është ndërtuar më 1585. Xhamia e Hadum-it pjesë e kompleksit, e ndërtuar nga Efendi Hadum Aga, konsiderohet si objekti i parë themeltar i qytetit. Çarshia e Gjakovës është restauruar disa herë pas djegies gjatë luftës së fundit në Kosovë, kur është shkatërruar në tërësi. Mungojnë shenjat orientuese për të arritur deri tek ky aset.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 24.09.2018

Emri i asetit:	Shtëpia Tradicionale Ryshyt Këpuskës
Statusi ligjor:	Mbrojtje të Përkohshme nr. 4097
Lokacioni:	Gjakovë
Shuma e ndarë:	40,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet
Shtëpia tradicionale e Ryshyt Këpuskës, gjendet në qytetin e Gjakovës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme nga MKRS me numër unik 4097, dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Mungojnë shenjat informuese se ku gjendet shtëpia tradicionale, ndërsa qasja rrugore deri tek aseti është e asfaltuar. Hyrja brenda në aset ishte e pamundur pasi që gjendja ekzistuese e asetit është shumë e keqe në mungesë të intervenimit nga institucionet kompetente. Edhe pse MKRS, për vitin 2018 ka planifikuar 40,000.00 euro, mirëpo ende nuk kanë filluar intervenimet.	



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 24.09.2018

Emri i asetit:	Shtëpia e Nimon Ferizit
Statusi ligjor:	Mbrojtje të Përkoshme 785
Lokacioni:	Gjakovë
Shuma e ndarë:	30,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet
Shtëpia e Nimon Ferizit, gjendet në qytetin e Gjakovës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme nga MKRS me numër unik 785, dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Mungojnë shenjat, informuese se ku gjendet Shtëpia e Nimon Ferizit. Gjendja asetit nuk është e mirë, si nga jashtë ashtu edhe nga brenda, para pesë vitesh një pjesë e saj ishte rrënuar. Për vitin, 2018, janë planifikuar 30,000.00 euro nga MKRS.	



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 24.09.2018

Emri i asetit:	Kulla e Ethem Godenit
Statusi ligjor:	Mbrojtje e Përkohshme, nr.2607
Lokacioni:	Rogovë - Gjakovë
Shuma e ndarë:	20,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet
Kulla e Ethem Godenit gjendet në mes të fshatit Rogovë të Gjakovës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme nga MKRS me numër unik 2607 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Për t'u qasur deri të kulla mungojnë shenjat oreintuese – informuese. Gjendja ekzistuese e kullës është shumë e keqe, madje kjo mund të vërehet edhe nga qarjet e mureve të jashtme. Kulla e Ethem Godenit është në pronësi private dhe deri më tani nuk ka pasur asnjë intervenim me karakter shpëtimi edhe pse në vitin 2018 MKRS ka ndarë mjete buxhetore për këtë aset.	



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 24.09.2018

Emri i asetit:	Kulla e Ramë Zeqës
Statusi ligjor:	Mbrojtje e Përkohshme, 1447
Lokacioni:	Brovinë–Gjakovë
Shuma e ndarë:	20,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet


Kulla e Ramë Zeqës gjendet në fshatin Brovinë të Gjakovës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme në vitin 2017 nga MKRS me numër unik 1447 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Për këtë aset mungojnë shenjat informuese të cilat tregojnë se është në mbrojtje të përkohshme. Vërehet së gjendja ekzistuese e kullës është shumë e keqe, muret dhe çatia e kullës kanë filluar të shkatërrohen. Kulla e Ramë Zeqës është në pronësi private. Për vitin 2018 janë ndarë 20,000.00 euro por që ende nuk kanë filluar intervenimet.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 22.09.2018

Emri i asetit:	Mulliri dhe koshi (Hambari) i familjes Jonuzaj
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr.4509
Lokacioni:	Senik – Malishevë
Shuma e ndarë:	20,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet

Mulliri dhe Koshi i familjes Jonuzaj gjenden në fshatin Senik të komunës së Malishevës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 4509 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Mulliri gjendet në luginën dhe rrjedhën e lumit të fshatit dhe qasja deri te aseti është e vështirë për shkak të vegetacionit të shumtë. Hambari (koshi) gjendet në oborrin e shtëpisë ku jeton aktualisht familja Jonuzaj dhe qasja në të është më e lehtë. Nuk ka tabela orientuese për vendndodhjen e këtyre aseteve. Gjendja aktuale e Mullirit është e keqe pasi që ka filluar të shkatërrohet si nga jashtë ashtu edhe nga brenda. Dëmtimet janë më të theksuara në kulm, makinerinë për bluarje që ka shërbyer për këtë mulli, ndërsa Hambari (koshi) është në gjendje të mirë falë kujdesit të familjes Jonuzaj të cilët e kanë ruajtur dhe mbajtur funksional deri më tani.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 24.09.2018

Emri i asetit:	Mulliri i Islam Zenel Kryeziu
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme 1283
Lokacioni:	Pagarushë- Malishevë
Shuma e ndarë:	20,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet
Mulliri i Familjës Kryeziu gjendet në fshatin Pagarushë të Malishevës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme në vitin 2017, nga MKRS me numër unik 1283, dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Mungojnë tabelat informuese dhe orientuese se ku gjendet mulliri, që është aset në mbrojtje të përkohshme. Gjendja fizike e asetit-mullirit është shumë e rëndë. Mulliri është në pronësi private, nuk ka pasur intervenime emergjente, edhe pse për vitin 2018, MKRS ka ndarë mjete buxhetore prej 20,000.00 euro për rregullimin e këtij mulliri, punët ende nuk kanë filluar.	



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 24.09.2018

Emri i asetit:	Kulla e familjes Tafollit
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr.1208
Lokacioni:	Qadrak – Suharekë
Shuma e ndarë:	20,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet

Kulla e familjes Tafolli gjendet në fshatin Qadrak të komunës së Suharekës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme që nga viti 2015 me numër unik 1208, i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Gjendja e asetit vazhdon të jetë shumë e keqe edhe pse MKRS ka ndarë mjete buxhetore për punime restauruese, deri më tani nuk vërehet se kanë filluar ato. Struktura e mureve nuk është stabile dhe ato kanë filluar të dëmtohen edhe më shumë pas shembjes së një pjese të kulmit të Kullës. Nuk ka qasje të mirë rrugore dhe i mungojnë shenjat informuese.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datë 25.09.2018

Emri i asetit:	Kisha Katolike e Ferizajit
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr. 4246
Lokacioni:	Ferizaj
Shuma e ndarë:	50,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet

Kisha Katolike e Ferizajit gjendet në qendër të qytetit të Ferizajit, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 4246 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Gjendja e jashtme e asetit duket të jetë e mirë, ndërsa brenda ka qarje të shumta në mure dhe për shkak të tyre gjatë kushteve të rënda atmosferike uji depërton brenda ambienteve të kishës.

MKRS për vitin 2018 ka planifikuar mjete në vlerë 50 mijë euro, mirëpo deri në ditën e vizitës sonë nuk ishte bërë asnjë intervenim restaurues/koservues dhe as personeli i kishës nuk ishte i informuar se do të bëhet ndonjë intervenim i tillë. Për këtë aset mungon tabela informuese të cilat tregojnë se është në mbrojtje të përkohshme.



Fotografite e bëra nga KKTK me datë 28.09.2018

Emri i asetit:	Mulliri dhe Valanica e Visheve
Statusi ligjor:	Mbrojtje e Përkohshme nr.596
Lokacioni:	Binqë – Viti
Shuma e ndarë:	20,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet

Mulliri dhe Valanica e Visheve gjendet në fshatin Binqë të Vitisë, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 596 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Qasja deri në këtë aset është e vështirë pasi që është e mbuluar nga vegjetacioni.

Gjendja e asetit është shumë e keqe pasi në të dy objektet kanë filluar të rrënohen muret dhe kulmi. Banorët thonë së dikush nga komuna e ka kthyer në pronë komunale dhe për këtë janë në kontest gjyqësor me Komunën e Vitisë. Për këtë aset mungojnë shenjat orientuese dhe informuese të cilat tregojnë se është në mbrojtje të përkohshme.



Fotografite bëra nga KKTK me datë 28.09.2018

Emri i asetit:	Xhamia e Vryqecit
Statusi ligjor:	Mbrojtje të Përkoshme nr.246
Lokacioni:	Vryqec, Kamenicë
Shuma e ndarë:	30,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet

Xhamia e vjetër e Vryqecit gjendet në fshatin Vryqec të Kamenicës, është aset i shpallur në mbrojtje të përkohshme nga MKRS, me numër unik 246, dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale. Mungojnë tabelat orientuese për lokacionin e xhamisë, ndërsa qasja rrugore deri në aset është e paasfaltuar dhe e vështirë. Për t'u qasur deri të xhamia duhet ecur këmbë. Gjendja e xhamisë është shumë e keqe, duke u vetëshkatërruar nga vjetërsia e saj që sipas një banori është mbi 400 vjet. Nëse nuk do të bëhen ndërhyrje restauruese/konservuese xhamia rrezikon të shembet. Deri më tani nuk ka pasur intervenime dhe për vitin 2018 MKRS, kishte planifikuar 30,000.00 euro, mirëpo deri më tani nuk është bërë asgjë.




Fotografite e bëra nga KKTK me datë 29.09.2018

Emri i asetit:	Rezidenca e Presidentit Ibrahim Rugova
Statusi ligjor:	Mbrojtje të përkohshme nr. 4234
Lokacioni:	Lagjja Velania, Prishtinë
Shuma e ndarë:	60,000.00 €
Viti:	2018
Punëkryesi:	Nuk dihet

Rezidenca e Presidentit Ibrahim Rugova gjendet në lagjen Velania në Prishtinë, është aset shpallur në mbrojtje të përkohshme me numër unik 4234 dhe i përket kategorisë së trashëgimisë arkitekturale.

Nga jashtë gjendja e asetit duket të jetë e mirë por vërehen disa çarje në mure. Vërehet se është duke u punuar në të, mirëpo në ditën e vizitës sonë nuk ishte askush nga punëkryesi apo familjarët që të marrim informacione rreth punimeve. Për këtë aset MKRS për vitin 2018 sipas linjave buxhetore ka ndarë 60 mijë euro. Për këtë aset mungojnë shenjat informuese të cilat tregojnë se është në mbrojtje të përkohshme.



Fotografitë e bëra nga KKTK me datën 12.10.2018

PROJEKTET E TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE (JOMATERIALE)

Trashëgimia shpirtërore - jomateriale është njëra ndër kategoritë ligjore të trashëgimisë kulturore që përfshinë format e shprehjes kulturore të traditave ose të zakoneve, të gjuhës, festave, riteve, valles, muzikës, këngës dhe shprehjes artistike. Ajo paraqet rëndësi të veçantë pasi trajton elemente të krijimtarisë kulturore që në klasifikimet e mëhershme ishin lënë pas dore. Sidoqoftë, gjendja e kësaj kategorie të patrajtuar kërkon ndërhyrje dhe angazhim konkret për shkak të natyrës së ndjeshme me qëllim shpëtimin e vlerave dhe të elementeve të papërsëritshme të saj.

MKRS për periudhën 2008-2018 në projekte të trashëgimisë shpirtërore ka ndarë dukshëm më së paku mjete krahasuar me kategoritë e tjera. Kështu pra, trashëgimia shpirtërore jo vetëm për nga numri i projekteve por edhe shuma dhe destinimi i tyre mbetet shumë e pambrojtur dhe e cenueshme, përkundër që është shpallur prioritet me Strategjinë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017-2027, dokument i miratuar nga Qeveria e Kosovës në vitin 2017.

Kështu për shembull edhe një element i mirënjohur si “Eposi i Kreshnikëve” vazhdon të jetë në mbrojtje të përkohshme, pa u ndërmarrë veprime të nevojshme për ta kompletuar dhe shpall në mbrojtje të përhershme si trashëgimi shpirtërore e Republikës së Kosovës. Gjithashtu ka edhe elemente tjera të trashëgimisë shpirtërore me vlera unike që rrezikojnë të humben pasi nuk janë fare pjesë e listës së përkohshme.

Trashëgimia shpirtërore deri në vitin 2015 nuk ka figuruar fare në listën e aseteve në mbrojtje të përkohshme të hartuar nga MKRS. Ministria e Kulturës ka ndarë shuma për projektin “Digjitalizimi i Materialit Zanor”, në periudhën 2010-2014, por nuk dihet se çfarë është realizuar konkretisht në kuadër të tij. Projekte të tjera që kanë lidhje me trashëgiminë shpirtërore nuk figurojnë fare deri në vitet 2017-2018. As në kuadër të projektit “Mbrojtja dhe ruajtja, studimi dhe promovimi i trashëgimisë shpirtërore” nuk dihet se çfarë është realizuar konkretisht nga këto mjete pasi nuk specifikohet askund. Jo rrallë ndodh që të bëhet edhe ridestinimi i mjeteve nga kjo kategori për projekte të tjera.

Tabela 5. *Lista e projekteve kapitale në trashëgimi shpirtërore për periudhën 2010-2018 dhe përmban shumën e përgjithshme.*

Nr.	Emri i Projektit	Shuma
1.	Digjitalizimi i Materialit zanor	280,000.00
2.	Mbrojtja dhe ruajtja, studimi dhe promovimi i trashëgimisë shpirtërore	280,000.00
3.	Digjitalizimi i materialit muzikor	320,000.00
Totali		880,000.00 €

PROJEKTE TË TJERA TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Në kuadër të projekteve kapitale për trashëgiminë kulturore janë ndarë mjete të konsiderueshme për masat preventive, intervenimet emergjente dhe të cilat nuk janë të specifikuara për cilat asete të trashëgimisë kulturore janë bërë këto ndërhyrje. MKRS nuk ka hartuar një listë të aseteve të trashëgimisë kulturore në rrezik në bazë të së cilës do të bëheshin ndërhyrje emergjente. Këto mjete janë destinuar dhe ndarë nëpër Qendrat Regjionale të Trashëgimisë Kulturore (Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjakovë, Gjilan dhe Mitrovicë) dhe në institucionet e trashëgimisë kulturore vartëse të MKRS-së.

Gjithashtu edhe për Turizmin Kulturor janë planifikuar mjete, por për të cilat nuk ka informacione se ku janë investuar apo për çfarë destinacioni janë përdorur ato. Në këtë kuadër nuk kemi botime apo guida turistike për asetet e trashëgimisë kulturore, broshura, fletushka dhe nuk kemi një promovim të denjë për turizmin kulturor që do kontribuonte në zhvillimin ekonomik, kur dihet se trashëgimia kulturore është potencial ekonomik mjaftë i rëndësishëm.

Kosova ka një fond të pasur të ekspoziteve në sektorin e natyrës të cilat për një kohë të gjatë gjenden në kushte shumë të rënda papërkujdesje në hapësirat e Muzeut të Kosovës. MKRS për ndërtimin e Muzeut të Natyrës ka ndarë mjete buxhetore për herë të parë në vitin 2016. Që nga ajo kohë përveç ndarjes së lokacionit dhe studimit të fizibilitetit nuk kemi ndonjë veprim konkret, derisa ekspozatat dita ditës janë duke u shkatërruar nga myku, lagështia duke rrezikuar humbjen e këtij thesari mjaft të çmuar natyror për Kosovën.

Një shumë e konsiderueshme mjetesh buxhetore është ndarë edhe për kthimin e thesarit Arkeologjik dhe Etnologjik të Kosovës, por që deri më tani në këtë aspekt thuajse nuk është bërë përparim. Nuk dihet se çfarë veprimesh janë ndërmarrë për këtë qëllim, por dihet se deri më tani janë ndarë 252,683.00 euro (€). Madje, Republika e Kosovës nuk ka arritur të përdorë në favor të kthimit të artefakteve as dokumentin “Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës” ANEKSI V Trashëgimia fetare dhe kulturore, Neni 6, ku thuhet se: ***“Republika e Serbisë, brenda 120 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj zgjidhjeje, do t’i kthejë artefaktet arkeologjike dhe etnologjike të cilat janë marrë hua nga muzetë e Kosovës për ekspozim të përkohshëm në Beograd gjatë viteve 1998-1999”***.¹ Krejt çka është arritë deri më sot është kthimi

¹ <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Propozim%20per%20Statusin%20e%20Kosoves.pdf>

i një ekspoziti të vetëm – Hyjnesha në Fron e marrë në vitin 2002 nga kryeadministratori i atëhershëm i UNIMK-ut gjatë vizitës së tij në Beograd.

Mjete financiare në projekte kapitale janë ndarë edhe për Regjistrimin dhe digjitalizimin e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Në bazë të të dhënave publike nuk specifikohet se çfarë është realizuar deri më tani, përveç Databazës së trashëgimisë kulturore, e cila është bashkëfinancuar me fonde ndërkombëtare. Megjithatë kjo databazë është jofunksionale dhe me mangësi teknike, mungesë të dhënash, ajo përmban informata të pasakta si dhe nuk është e mirëmbajtur dhe as e azhurnuar.

Përkundër mjeteve financiare të shumta që janë ndarë për shenjëzimin dhe ndriçimin e aseteve të trashëgimisë kulturore, pothuajse shumica e aseteve nuk e kanë të zgjedhur këtë çështje. Madje, MKRS nuk e ka bërë as shenjëzimin dhe ndriçimin për 23 asetet e shpallura në mbrojtje të përhershme nga viti 2016.

Gjithashtu ka edhe projekte të tjera të financuara nga MKRS siç janë shtatorët dhe bustet, etj., që nuk janë fare pjesë e listës së trashëgimisë kulturore.

Tabela 4. *Lista e projekteve tjera kapitale në trashëgimi kulturore për periudhën 2010-2018*

Nr.	Emri i Projektit	Shuma
1.	Masat preventive, intervenimet emergjente	2,315,000.00
2.	Kthimi i thesarit Arkeologjik dhe Etnologjik të Kosovës	252,683.00
3.	Rexhistrimi dhe Digjitalizimi i Trashëgimisë Kulturore të Kosovës	150,000.00
4.	Turizmi kulturor i Kosovës	305,293.00
5.	Muzeu i natyrës /studimi i fizibilitetit dhe projektit ideor	329,000.00
6.	Laborator për konservim dhe restaurim	120,000.00
7.	Shtatorja e Anton Çetës	50,000.00
8.	Busti i presidentit Ibrahim Rugova	97,000.00
9.	Kosova gjatë shekujve	369,398.00
10.	Shenjëzim i trashëgimisë kulturore	50,000.00
11.	Ndriçimi i objekteve të trashëgimisë kulturore	250,000.00
12.	Ngrohja qendrore në IMM	11,000.00
Totali		4,299,374.00 €

KAPITULLI II – PROJEKTET E INVESTUARA NË OBJEKTE PA STATUS TË MBROJTJES LIGJORE

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përgjatë viteve 2008-2018 ka planifikuar dhe ndarë mjete buxhetore për objekte të cilat nuk gëzojnë status të mbrojtjes ligjore. Në bazë të hulumtimit që ka bërë KKTK për projektet e trashëgimisë kulturore rezultoi se janë rreth njëzet (20) objekte që nuk kanë status të mbrojtur në të cilat janë kryer ndërhyrje dhe/apo rindërtime të tyre në shumë prej 1,107,683.00 euro (€).

Ekziston lista e mbrojtjes së përkohshme me mbi 1500 asete si dhe lista në mbrojtje të përhershme prej 23 Asete për të cilat MKRS do të duhej të përkujdesej duke marrë parasysh se ka shumë asete të trashëgimisë kulturore që kanë nevojë për investime për shkak të gjendjes së tyre. Fondet nga kategoria e trashëgimisë kulturore duhet të shkojnë sipas destinimit të tyre dhe jo për objekte që nuk kanë status ligjor.

Tabela 6. *Investimet në objekte pa status të trashëgimisë kulturore*

Nr.	Emri i objektit	Lokacioni	Shuma	Viti
1.	Ndërtesa e Arkivit Shtetëror të Kosovës	Prishtinë	55,000.00	2018
2.	Qendra Historike e Prishtinës	Prishtinë	80,000.00	2018
3.	Muzeu i Paqes	Nuk dihet	50,000.00	2018
4.	Konservimi i skulpturave të Agim Çavdërbashës	Prishtinë	150,000.00	2018
5.	Restaurimi i Akademisë së Parë Ushtarake të UÇK	Aqarevë	75,000.00	2012 2018
6.	Kulla- Shtabi i UÇK-së Ashlan	Ashlan- Vushtrri	52,683.00	2013
7.	Kulla e Ismet Rrahmanit	Aqarevë- Skenderaj	70,000.00	2015
8.	Kulla e Shaban Manxhollit	Mikushnicë- Skenderaj	40,000.00	2018

9.	Ndërtimi i Muzeu i Luftës dhe Odës së fshatit Lybeniqit	Lybeniq - Pejë	100,000.00	2018
10.	Mulliri i Mehmet Alisë	Marali-Malishevë	20,000.00	2018
11.	Rikonstruimi i Objektit ndihmës të Kishës në fshatin Borcan	Mushikove-Prizren	15,000.00	2017
12.	Teqja në Gjilan	Gjilan	130,000.00	2011
13.	Kompleksi Rexhep Malaj	Kamenicë	50,000.00	2018
14.	Kompleksi përkujtimor “Presidenti historik Dr. Ibrahim Rugova”	Prishtinë	160,000.00	2011 dhe 2012
15.	Renovimi i Galerisë së Arteve në Kullën e Ali Kadriut	Kroi i Vitakut, Mitrovicë	20,000.00	2018
16.	Kulla e Familjes Fanaj	Vermicë -Prizren	40,000.00	2018
Totali			1,107,683.00 €	

KAPITULLI III – KOMPANITË NDËRTIMORE QË KANË KRYER PUNIME NË ASETE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

KKTK në kuadër të hartimit të këtij raporti për gjendjen e trashëgimisë kulturore ka hulumtuar edhe profilin e kompanive ndërtimore që janë kontraktuar në projekte kapitale nga MKRS për kryerjen e punimeve konservuese/restauruese dhe punë të tjera teknike në asete.

Nga të dhënat e grumbulluar dhe gjetjet e hulumtimit rezulton se kompanitë ndërtimore nuk janë të licencuara për kryerjen e punimeve konservuese dhe restauruese në asete të trashëgimisë kulturore, siç kërkohet me nenin 4.16 të Ligjit për Trashëgimi Kulturor.

Në vijim paraqitet lista e kompanive ndërtimore të cilat kanë realizuar projekte kapitale në trashëgimi kulturore për periudhën 2010-2018. Kjo tabelë përmban shumën e përgjithshme për punime të kryer nga kompanitë ndërtimore.

Nr.	Kompania	Adresa	Shuma e përgjithshme
1.	N.P.N.I “ARTING” Sh. P.K	Gjakovë	1,099.594.38 €
2.	Sh. P. K „American Invest Company“	Gjakovë	794,012.68 €
3.	N.T “PLEQJA”	Isniq, Deçan	374,614.62 €
4.	“EURO PROJECT”	Skenderaj	366,331.93 €
5.	SHPK “VB STUDIO & FAMIS CO”SHA	Prishtinë	342,819.60 €
6.	”ARC PJOJECT”	Gjakovë	289,996.98 €
7.	„P.A.B“ Company	Gjakovë	278,692.01 €
8.	“NORTH-ËEST”SHPK& “ALB – ARCHITECT”SHPK N.N”GEOKOS A&A”	Fushë Kosovë	200,000.00 €
9.	“ALBI COMPANY”	Rahovec	175,968.92 €
10.	P.M.N. – SH.P.K.	Prishtinë	163,538.88 €
11.	“ ADLER COM”Sh.p.k	Gjakovë	151,230.00 €
12.	“SMAKAJ”	Suharekë	136,051.28 €
13.	N.N.SH “REING”Sh.p.k	Gjakovë	132,024.37 €
14.	“ADHURIMI”	Junik	115,433.25 €
15.	KONZORCIUMI: “BROTHERS GROUP” & “ENEX TRADE” & “LINDI”	Prishtinë	88,398.19 €
16.	N.H “DUKAGJINI”	Gjakovë	79,581.61 €
17.	“NBT-ING” SHPK	Suharekë	64,662.43 €
18.	“A+A OSMANI”	Gjakovë	59.601.00 €
19.	N.N.P. ARHIKO – ING,	Prishtinë	46,681.28 €
20.	“BEJTA COMMERCE”	Gjilan	42.424.20 €
21.	“ASTRA PLAN” SHPK	Prishtinë	37,929.00 €
22.	IZOL PROMET	Graçanicë	35,395.40 €
23.	“GJEOKONSULTING”	Viti	33.005.08 €
24.	Lot 5. ”MABB CONSTRUCTION”SH.P.K	Gjilan	26,628.00 €

25.	N. P. N"OLSKA ING"	Prishtinë	22,765.03 €
26.	N.N.P. "PETRITI"	Ferizaj	19,510.00 €
27.	N.TP"TERMOPLAST"	Suharekë	18,195.00 €
28.	"V.B. STUDIO"	Prishtinë	15,998.00 €
29.	"FERBAING"	Suharekë	10,261.00 €
30.	NPN "BVB.COM"	Ferizaj	9,840.00 €
31.	SH.P.K "AL GROUP"	Prishtinë	9,487.00 €
32.	N.N.P "LINDI"	Istog	7,995.64 €
33.	"ALFA – I"	Istog	7,957.10 €
34.	"PROJEKT PLUS" SH.P.K	Prishtinë	6,980.00 €
35.	N. N. P"TONI"	Malishevë	6,446.00 €
36.	N.N.SH. "KAPITAL" & "ALPING"	Prishtinë	6,432.00 €
37.	"DEKOR GROUP" SH.P.K	Prishtinë	4,986.50 €
38.	N.N.SH "TOP PROJECT"	Prishtinë	4,465.00 €
39.	N.N.T. "KOMPAKT"	Prishtinë	3,869.52 €

**Të dhënat e paraqitura në tabelë janë marr nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik*

SHTOJCA 1. **PROJEKTET E PLANIFIKUARA NGA MKRS PËR VITIN 2019**

Projektet e planifikuara për vitin 2019 nga MKRS në bazë të projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës nuk garantojnë rezultate dhe përmirësim të gjendjes, duke pas parasysh se është marrë përbazë parimi i njejtë i ndarjes së projekteve sipas viteve të mëhershme.

Tabela 5. *Lista e projekteve kapitale në trashëgimi kulturore për 2019*

Nr.	Emri i Projektit	Shuma
1.	Kalaja e Prizrenit	80,000.00
2.	Lokaliteti Ulpiana	80,000.00
3.	Lokaliteti Dresnik	70,000.00
4.	Kalaja e Harilaqit	50,000.00
5.	Kalaja e Dardanës	50,000.00
6.	Kalaja e Vuçakut	50,000.00
7.	Kalaja e Korishës	50,000.00
8.	Kalaja e Artanës	40,000.00
9.	Kalaja e Keqekollës	20,000.00
10.	Kalaja në Marec	20,000.00
11.	Ura e gurit në Vushtrri	15,000.00
12.	Kthimi i thesarit Arkeologjik dhe Etnologjik të Kosovës	10,000.00
13.	Lokaliteti arkeologjik i Barilevës	10,000.00
14.	Lokaliteti Arkeologjik në Gllamnik	10,000.00
15.	Renovimi i Ndërtesës së Arkivit Shtetëror të Kosovës	500,000.00
16.	Objekti i MKRS-së në Prizren	200,000.00
17.	Qendra Historike e Prizrenit	100,000.00
18.	Përfundimi i punimeve në kishat ortodokse	100,000.00
19.	Kompleksi Rexhep Malaj në Kamenice	50,000.00
20.	Muzeu Arkeologjik në Prizren	50,000.00
21.	Restaurimi i Akademisë së parë Ushtarake në Aqarevë	40,000.00
22.	Ndërtimi i Kullës së Shaban Mangjollit, Mikushnice-Skenderaj	40,000.00
23.	Kulla në Lubizhdë të Hasit	40,000.00
24.	Shtëpia e Kultures në Runik	40,000.00
25.	Rindërtimi i kullës së Sef Mleqanit	40,000.00
26.	Kulla në Lubizhdë të Hasit	40,000.00
27.	Konservimi dhe restaurimi i Shtëpisë së Xhafer Deves	30,000.00
28.	Konservimi dhe restaurimi i Shtëpisë së Shaban Agës në Vushtrri	30,000.00
29.	Kompleksi Etnologjik "Emin Gjiku"	30,000.00
30.	Shtëpia e familjes Koruglu në Mitrovicë	30,000.00
31.	Shtëpia e Herticeve në Prishtinë	30,000.00
32.	Qarshia e Gjakoves	30,000.00
33.	Kulla e familjes Fanaj, Vermice	30,000.00

34.	Kisha Katolike ne Ferizaj	30,000.00
35.	Kulla e Sheremetit në Pejë	20,000.00
36.	Muzeu i Pages	20,000.00
37.	Mulliri i Mehmet Alise ne Marali, Malisheve	20,000.00
38.	Mulliri, Hambari i Familjes Januzaj ne Senik, Malisheve	20,000.00
39.	Mulliri i familjes Kryeziu, Pagarushe, Malisheve	20,000.00
40.	Renovimi i Galerise ne Kullen e Ali Kadriut ne Kroin e Vitakut, Mitrovice	20,000.00
41.	Konservimi dhe restaurimi i Shtepisë së Shaban Agës në Vushtri	20,000.00
42.	Konservimi i shtepise se Adem Demacit	20,000.00
43.	Ndertesa e Shtabit, Brigada 121	20,000.00
44.	Muzeu i Mitrovices	20,000.00
45.	Muzeu i Gjilanit	20,000.00
46.	Muzeu Etnografik ne Peje	20,000.00
47.	Muzeu Etnografik ne Gjakove	20,000.00
48.	Ndërtesa e Teatrit në Ferizaj	20,000.00
49.	Renovimi i depove të Muzeut të Kosoves	20,000.00
50.	Kulla e Hamëz Tafë Metaj-Baballoq	20,000.00
51.	Shtëpia Muze " Fadil Vata" - Sallagrazhdë	20,000.00
52.	Kulla e Ramë Bllacës-Bllacë	20,000.00
53.	Kulla e Isa Boletinit	20,000.00
54.	Shtëpia e Mulla Ademit ne Keqekolle	15,000.00
55.	Kulla e Shaban Polluzhes	10,000.00
56.	Kulla në Oroberdë / Istog	10,000.00
57.	Fshati Hoqe e Madhe	10,000.00
58.	Fshati Zym	10,000.00
59.	Shtëpia tradicionale Ryshyt Kepuska, Gjakove	10,000.00
60.	Mulliri dhe Velanica e Visheve ne Binq, Viti	10,000.00
61.	Konaku i Mehmet Begolleve	10,000.00
62.	Kulla e Zeqe Rame Sadrise, Brovine	10,000.00
63.	Kulla e familjes Tafollaj ne Çadrak, Suhareke	10,000.00
64.	Kulla e Shaban Polluzhes	10,000.00
65.	Kulla e Familjes Geci	10,000.00
66.	Xhamia e Vjetër në Shkozë	10,000.00
Totali		2,550,000.00 €

GJETJE DHE KONKLUZIONE

1. Mungesa dhe domosdoshmëria e vlerësimit të projekteve dhe përcaktimi i prioriteteve nga ana e KKTK paraqitet si çështje kryesore që do të kontribuonte në ndaljen e shkatërrimit të trashëgimisë kulturore. Në periudhën 2008 – 2018, nuk është dorëzuar në KKTK asnjë projekt për vlerësim nga institucionet e MKRS, siç përcaktohet në nenin 5.2 të Ligjit për Trashëgimi Kulturore. Të gjitha këto projekte vlerësohen nga një Komision që funksionon në kuadër të MKRS-së i themeluar në kundërshtim me ligjin. Si rezultat i kësaj praktike dhe moszbatimit të ligjit, projektet janë realizuar dhe realizohen në kundërshtim me kriteret dhe standardet profesionale si dhe shumë mjete buxhetore shpenzohen në objekte të cilat nuk gëzojnë status të mbrojtjes ligjore
2. Përkundër rritjes së buxhetit dhe investimeve të vazhdueshme, shpeshherë në projekte të njëjta, trendi i degradimit dhe shkatërrimit të aseteve të trashëgimisë kulturore aktualisht nuk shënon rënie. Përkundrazi, shkatërrimi vazhdon sidomos në zonat urbane dhe në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës
3. Mungesa e licencimit të kompanive siç parashihet me nenin 4.16 të LTK e të cilat bëjnë punime restauruese/konservuese dhe ndërhyrje tjera rezulton të jetë një nga shkaktarët kryesorë të dëmtimit dhe ndërhyrjeve joprofesionale e jocilësore në asetet e trashëgimisë kulturore
4. Gjendja e aseteve të trashëgimisë arkeologjike mbetet e pakonsoliduar, megjithë investimet e përvitshme dhe me projekte të vazhdueshme. Gjithashtu, gjërmimet me karakter shpëtimi shpeshherë bëhen edhe në lokalitete të njohura arkeologjike, të cilat nuk janë të rrezikuara nga ndikimet apo dëmtimet e faktorëve natyror dhe njerëzor. Problematike mbetet çështja e pronësisë së tokës private ku shtrihet trashëgimia arkeologjike
5. Mungesa e licencimit të personave juridik dhe fizik që bëjnë gjërmime arkeologjike sipas nenit 7.21 të LTK paraqet shkelje ligjore me pasoja për trashëgiminë arkeologjike të vendit.
6. Trafikimi i objekteve të luajtshme paraqet dëmtim dhe humbje të trashëgimisë kulturore, pasi që nuk bëhet në përputhje me nenin 9.26 të LTK i cilin parasheh licencimin e personave fizik dhe juridik që merren me shitjen-blerjen e artefakteve
7. Kthimi i thesarit arkeologjik dhe etnologjik të Kosovës që është plaçkitur nga Serbia në vitet 1998/99, mbetet çështje e pazgjidhur, përkundër mjeteve të ndara për disa vite nga

MKRS për këtë linjë buxhetore. Nuk dihet se çfarë është realizuar në këtë drejtim pasi nuk ka ndonjë politikë programore, fushatë dhe asnjë rezultat për kthimin e artefakteve.

8. Mungesa e kontrollit dhe llogaridhënies në trashëgimi kulturore rezulton si sfidë për institucionet në parandalimin e shkatërrimeve të qëllimshme apo për shkaqe tjera të ndryshme (natyrore, vjetërsia, mosmirëmbajtja etj)
9. Ridestinimi i mjeteve për trashëgimi kulturore nga MKRS vjen si rezultat i planifikimit të dobët dhe mospërfundimit me kohë të projekteve
10. Mosbashkëpunimi i MKRS-së me pronarët e aseteve që gëzojnë statusin e mbrojtjes së përkohshme paraqitet si sfidë. Në këtë aspekt, mund të thuhet se mungon pothuajse tërësisht komunikimi dhe njoftimi i pronarëve lidhur me të drejtat dhe obligimet e tyre duke humbur mundësinë për involvimin e komuniteti si akterë aktivë dhe promotorë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Në shumë raste pronarët nuk janë të informuar për ndërhyrjet dhe projektet që zhvillohen në objektet e tyre. Si rezultat i kësaj dhe interesave të ndryshme ekonomike, sociale, të sigurisë e tjera, shpeshherë pronarët e objekteve/aseteve tentojnë që ato ti heqin nga lista e trashëgimisë kulturore duke mos zgjedhur mënyra për arritjen e këtij qëllimi. Shtytës i kësaj është edhe presioni nga zhvillimi urban në dhe përreth qendrave të qyteteve, ku edhe zakonisht janë të vendosura asetet e trashëgimisë kulturore
11. Vazhdimi i statusit për cdo vit nga MKRS për asete që janë pjesë e listës së përkohshme është në kundërshtim me Ligjin për trashëgimi kulturore, neni 3.6 pasi ato nuk mund të jenë më shumë se një vit në mbrojtje të përkohshme. MKRS gjatë kësaj periudhe të mbrojtjes së përkohshme është e obliguar të përgatit dokumentacionin e nevojshëm dhe ta përcjellë në KKTK për shpallje në mbrojtje të përhershme
12. Shtimi i numrit të aseteve në listën e mbrojtjes së përkohshme pa plan për trajtimin dhe shfrytëzimin e tyre mbetet problematikë tjetër
13. Mungesa e stafit profesional në fushat e trashëgimisë kulturore është sfidë dhe një prej shkaktarëve që gjendja mbetet e papërmirësuar. Në të gjitha institucionet e kësaj fushëveprimtarie janë rreth 80 punonjës profesional që mbulojnë fusha të ndryshme të trashëgimisë kulturore
14. Mungesa e shënjëzimit dhe ndriçimit në asetet e trashëgimisë kulturore, në veçanti për njëzetetë (23) asetet e shpallura në mbrojtje të përhershme.

REKOMANDIME

1. Respektimi i Ligjit për Trashëgimi Kulturore dhe ligjeve tjera të fushës
2. Vlerësimi i projekteve nga ana e institucionit kompetent – Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
3. Përcaktimi i qartë i prioriteteve financiare vjetore për trashëgimi kulturore nga institucioni përgjegjës – Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
4. Mbikqyrja e ndërhyrjeve restauruese/konservuese nga ana e institucioneve përgjegjëse
5. Mbikqyrja dheurvejimi arkeologjik gjatë projektimit të autorrugëve dhe veprave infrastrukturore në Kosovë
6. Ndarja e mjeteve buxhetore për shpronësimin e aseteve të trashëgimisë kulturore me rëndësi të vecantë
7. Bashkëpunimi me pronarët e aseteve të trashëgimisë kulturore
8. Përfshirja e komunitetit ku shtrihen asete të trashëgimisë kulturore
9. Licencimi i personave juridik dhe fizik për ndërhyrje konservuese/restauruese të trashëgimisë kulturore
10. Licencimi i personave juridik dhe fizik që bëjnë gërmime arkeologjike.
11. Licencimi i personave fizik dhe juridik që merren me shitjen dhe blerjen e objekteve të trashëgimisë së luajtshme
12. Shenjzimi dhe ndriçimi i trashëgimisë kulturore në përputhje me standardet ndërkombëtare
13. Botimet dhe promovimi i trashëgimisë kulturore
14. Promovimi i diversitetit kulturor si vlerë e përbashkët
15. Rritja e stafit profesional në institucionet e trashëgimisë kulturore
16. Realizimi i projekteve të bëhet në bazë të prioriteteve, gjendjes faktike dhe arsyeshmërisë.